



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

**RREGULLORE
PËR
KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITË DHE PUNËN E KOMITETEVE JO TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT**

Gjilan, qershor 2015

Në bazë të nenit 12.1 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenit 65 paragrafi 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2015, miraton:

**RREGULLOREN
PËR
KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITË DHE PUNËN E KOMITETEVE JO TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT**

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të Komiteteve jo të përherëshme të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Përkufizimet

Neni 2

Me këtë rregullore përcaktohen disa nga përkufizimet më sa vijon:

“Komitetet jo të përherëshme” janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, të cilët punojnë për Kuvendin dhe në emër të Kuvendit.

“Material” paraqet të gjitha dokumentet të cilat i paraqiten komitetit përkatës nga drejtoria e cila është në vijë të linjës me atë komitet dhe nga institucionet tjera.

Qëllimi

Neni 3

Komitetet janë themeluar në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, me qëllim që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, pasi që Kuvendi nuk është në gjendje që në tërësi dhe në mënyrë adekuate, të merret me numrin e madh të çështjeve që mund të parashtrihen në Komunë. Shumë çështje me të cilat përballet Komuna janë të një natyre teknike, që kërkojnë angazhimin e ekspertëve, të cilët mund të mos jenë anëtarë të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të komiteteve përkatëse. Prandaj, komitetet e lehtësojnë punën e Kuvendit, duke e racionalizuar kohën e marrjes së vendimeve, për t’u ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit analiza profesionale, konsultime dhe angazhim për çështjet specifike.

1) Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 4

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjës për fushat që lidhen me kujdesin parësor dhe në kuadër të bashkëpunimit dhe të kujdesit shëndetësor.
 - 1.1.Përkujdeset për zbatimin e shërbimeve për kujdesin parësor shëndetësor në komunë;
 - 1.2.Shqyrton propozimet e drejtorit të QKMF dhe të Entit për Emergjencë nëpërmjet DSHMS;
 - 1.3.Shqyrton buxhetin për Sektorin e shëndetësisë dhe ia dorëzon atë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim;
 - 1.4.Shqyrton dhe jep propozime dhe sugjerime për Projekt-planin vjetor të punës, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.5.Shqyrton raportin vjetor, të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe mund të propozojë ndryshime ose plotësime, dhe t'ia dërgojë KPF – së dhe Kuvendit për miratim;
 - 1.6.Shqyrton dhe propozon programe për mbështetjen komunale grupeve të varfra të njerëzve (invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetimë, të pastrehët, të rikthyerit, pensionistët etj.) dhe propozon masa përkatëse;
 - 1.7.Mbështet Drejtorinë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave në lidhje me strehimin;
 - 1.8.Vlerëson propozimet e drejtorisë për strategjitë dhe planet e strehimit, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, renovimin e tyre si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre për këto qëllime;
 - 1.9.Shqyrton programet, në raste emergjente, për strehim të refugjatëve, planet dhe zgjidhjet emergjente për fluksin e refugjatëve dhe rikthimin në vendet e tyre dhe
 - 1.10. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

2) Komiteti për Arsim

Neni 5

1. Komiteti për Arsim është përgjegjës në fushat që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, kopshtet e fëmijëve, arsimin fillor, të mesëm të ulët si dhe arsimin e mesëm të lartë.
 - 1.1.Ndihmon drejtorinë për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për arsim;
 - 1.2.Shqyrton apelet dhe propozimet e nxënësve në lidhje me cilësinë e mësimin dhe masat disiplinore;
 - 1.3.Mbështet bashkëpunimin shkollë – shoqëri, në mes të institucioneve arsimore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimimin e personave;
 - 1.4.Ndihmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave arsimore të Komunës;
 - 1.5.Shqyrton propozimet dhe iniciacionin planet lokale arsimore;
 - 1.6.Propozon programet dhe projektet për autoritetet qendrore dhe drejtoritë që kanë të bëjnë me punën e këtij Kuvendi;

- 1.7.Mbështet bashkëpunimin shkollë – prindër, bashkëpunimin në mes të shkollave dhe komunitetit;
- 1.8.Shqyrton programet dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
- 1.9.Shqyrton prioritetet e programeve komunale në sferën arsimit dhe edukimit;
- 1.10. Shqyrton programet komunale për investimeve kapitale në arsim, , në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme; dhe
- 1.11. Ushtron përgjegjësi tjera, nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

3) Komiteti për Zhvillimin Ekonomik dhe Agrokulturë

Neni 6

1. Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe agrokulturë është përgjegjës për:
 - 1.1.përkrahjen e programeve të zhvillimit ekonomik të komunës, përfshirë këtu organizimin e panairëve të tregtisë dhe tregjeve, inkurajimin e biznesit dhe zhvillimin e turizmit, bashkëpunimin me bizneset lokale apo të përfaqësuara në nivel lokal;
 - 1.2.inicimin e programeve të projekteve zhvillimore ekonomike, për zonat urbane dhe rurale;
 - 1.3.shqyrtimin dhe propozimin e masave për sigurimin dhe mbrojtjen e pyjeve;
 - 1.4.shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin e bujqësisë;
 - 1.5.shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin ekonomik dhe të infrastrukturës në zonat industriale dhe në zonat e veçanta rurale;
 - 1.6.mbështetjen e rindërtimit të pjesëve të qytetit dhe të fshatrave;
 - 1.7.shqyrtimin e programeve të zhvillimit ekonomik në përgjithësi dhe
 - 1.8.ushton përgjegjësi tjera, nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

4) Komiteti për Planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 7

1. Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ushton këto përgjegjësi:
 - 1.1.shqyrton propozim-vendimin për qasje në hartimin e planeve urbanistike, propozim-vendimet për miratim të projekt-planeve urbanistike dhe atyre për miratim të këtyre llojeve të planeve;
 - 1.2.shqyrton propozimet e Drejtorisë së Urbanizëm, Mbrojtje të Mjedisit për prioritet dhe strategjitë e nxjerrjes, ndryshimit plotësimi dhe implementimit të planit zhvillimor komunal, urban dhe planeve rregulluese;
 - 1.3.shqyrton propozim-planin e punës dhe raportin e punës të drejtorisë së linjës, para prezantimit të tij për miratim nga Kuvendi i Komunës;
 - 1.4.shqyrton dhe inicion propozime për sigurimin e informatave të nevojshme lidhur me zhvillimet e ndërtimeve ilegale dhe marrjen e masave për parandalimin e tyre;

- 1.5.inicion dhe propozon masa për mbrojtjen e ambientit, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit, si dhe të zbatimit të ligjit dhe akteve tjera nënligjore nga ky lëmë;
- 1.6.shqyrton informatat mbi zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollin e standardeve të ndërtimit, dhe propozon masa për zbatim dhe kontrollin e tyre;
- 1.7.përkujdeset dhe propozon masa për ruajtjen e objektit, të shpallura me interes arkitektonik apo historik dhe
- 1.8.ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

5) Komiteti për Shërbime Publike, Banim, Mbrojtje dhe Shpëtim

Neni 8

Komiteti për Shërbime Publike, Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim është përgjegjës:

- 1.1.këshillon dhe konsultohet me drejtoritë e linjës;
- 1.2.shqyrton planet dhe raportet e punës së drejtorive të linjës;
- 1.3.përcjell zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve dhe veprimeve;
- 1.4.shqyrton propozimet për Bordin e drejtorëve dhe për ndërmarrjet publike që kryejnë shërbime komunale;
- 1.5.monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve; cakton burimet në përputhje me rrethanat;
- 1.6.shqyrton programet e ofrimit të shërbimeve për ujë dhe projektet për menaxhimin e ujërave të zeza;
- 1.7.shqyrton buxhetin e propozuar vjetor për shërbime, parashikimet e fondeve të nevojshme për personel, mallra dhe shërbime dhe investime;
- 1.8.shqyrton raportet për Kuvendin e Komunës, për sistemet operative dhe përmirësimet;
- 1.9.këshillon dhe konsultohet në lidhje me çështjen e mbledhjes së kuotave në arkëtim në të gjitha ndërmarrjet shërbyese;
- 1.10. shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me transportin publik dhe propozimet strategjike për rrugët lokale;
- 1.11. shqyrton programet për ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës;
- 1.12. shqyrton realizimin e projekteve të infrastrukturës;
- 1.13. shqyrton kërkesat e komuniteteve për ndërtimin e infrastrukturës;
- 1.14. monitoron realizimin e programeve për parqet, fushat rekreative dhe të argëtimit, shëtitoret publike, hapësirat publike të Komunës etj;
- 1.15. propozon masat e veçanta për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e këtyre masave;
- 1.16. shqyrton planet e veçanta dhe i propozon drejtorisë së linjës dhe Kuvendit të Komunës nxjerrjen e planit për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore , në mbështetje të vlerësimit të rrezikut nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga Ministria; dhe
- 1.17. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

6) Komiteti për Kulturë, Rini

Neni 9

1. Komiteti për Kulturë, Rini, Sport është përgjegjës:

- 1.1.për fushat që kanë të bëjnë kulturën, rininë dhe sportin;
- 1.2.ndihmon drejtorinë e linjës për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për kulturë, rini dhe sport;
- 1.3.mbështet bashkëpunimin kulturë - shoqëri ,në mes të institucioneve kulturore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimim dhe kulturë;
- 1.4.ndihmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave që lidhen me kulturë, rini dhe sport në Komunë;
- 1.5.shqyrton propozimet dhe iniciacionet lokale kulturore, rinore dhe sportive;
- 1.6.propozon programet dhe projektet për autoritetet lokale dhe qendrore që kanë të bëjnë me kulturë, rini dhe sport në Komunë;
- 1.7.mbështet kremtimin e festave shtetërore, lokale dhe ndërkombëtare, të njohura ndërkombëtarisht dhe propozon masat e nevojshme për realizimin e programeve kulturore, rinore dhe sportive;
- 1.8.shqyrton programet dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
- 1.9.përcjell zhvillimet ndërkombëtare që bëhen në lëmin e kulturës, rinisë dhe sportit që janë me interes për komunën;
- 1.10. përkujdeset që trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit t'i kushtohet rëndësi e veçantë;
- 1.11. shqyrton prioritetet e programeve komunale në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit;
- 1.12. shqyrton programet komunale për investime kapitale kulturë, rini dhe sport në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme;
- 1.13. shqyrton propozimet për anëtarët e Bordeve të ndërmarrjeve komunale nga sfera e kulturës dhe e sportit; dhe
- 1.14. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

7) Komiteti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Neni 10

1. Komiteti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është përgjegjës:

- 1.1. mbështet zhvillimin e ardhshëm të komunës, posaçërisht në lidhje me ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të pronës – paluajtshmërisë komunale;
- 1.2. shqyrton propozim-vendimet për dhënie në shfrytëzim të pronësisë komunale, para miratimit të tyre nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit;
- 1.3. shqyrton propozim-vendimet për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të paluajtshmërive në pronësi private, për të cilat destinohet realizimi i përmbytjeve të caktuara të objekteve me interes të përgjithshëm;

- 1.4. shqyrton masat për ruajtjen dhe kthimin e pronave komunale;
- 1.5. shqyrton propozim-vendimet për dhënie të tokës në pronësi komunale, në shfrytëzim për ndërtime të objekteve të interesit të përgjithshëm;
- 1.6. përcjell dhe përpunon zbatimin e legjislacionit që rregullon sferën e pronësisë në Kosovë, gjegjësisht në komunë;
- 1.7. trajton çështjen e uzurpimeve arbitrare të pronësisë komunale dhe propozon masa për kthimin e asaj prone dhe masat tjera ligjore ndaj uzurpuesve;
- 1.8. në bashkëpunim me Komitetin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, përkujdeset për mbajtjen e evidencave të pronës komunale, ruajtjen e regjistrave të tyre dhe transaksionet eventuale të kësaj prone;
- 1.9. shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me evidencimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pronave të Komunës dhe
- 1.10. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVL dhe me Statut të Komunës.

8) Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar

Neni 11

1. Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar është përgjegjës:
 - 1.1. mbështet bashkëpunimin ndërkufitarë për çështjet me interes që i preokupojnë qytetarët në të dy anët e kufirit të këtyre Komunave me të cilat kufizohet Komuna e Gjilanit;
 - 1.2. identifikimin e problemeve të përbashkëta, çështjet dhe objektivat që duhet formalizuar si pjesë e një marrëveshje bashkëpunimi, duke lehtësuar dhe ndihmuar jetën veçmas të fshatrave kufitare të dy anëve të kufirit;
 - 1.3. Shkëmbimin e përvojave për çështje të caktuara me interes të dyanshëm;
 - 1.4. Trajtimin e të zhvendosurve dhe angazhimi për krijimin e kushteve për kthim;
 - 1.5. Rekomandimin e çështjeve të caktuara për trajtim dhe zgjidhje në nivel të organeve lokale dhe qendrore që lidhen me çështjen e bashkëpunimit ndërkufitar;
 - 1.6. në respektimin e ligjeve të vendit dhe aktet tjera ndërkombëtare që njohin të drejtën e Komunave që të hyjnë në bashkëpunim brenda fushave të tyre të përbashkëta të kompetencës duke u këshilluar me njëri-tjetrin dhe duke nënshkruar marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitarë si në zhvillimin e shkëmbimeve ekonomike, kulturore, lehtësim të kalimeve nga një kufi në kufirin tjetër etj;
 - 1.7. shqyrton edhe çështje tjera të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, por të cilat delegohen nga organet tjera lokale dhe qendrore.

9) Komiteti për Barazi Gjinore

Neni 12

1. Komiteti për Barazi Gjinore është përgjegjës për:
 - 1.1. adresim të çështjeve të barazisë gjinore (historike, ekonomike, sociale, kulturore, e politike në nivel lokal);
 - 1.2. aftësim të kapaciteteve për një vendimmarrje gjithëpërfshirëse brenda komunës;

- 1.3. shpërndarje racionale dhe të drejtpeshuar të burimeve njerëzore, materiale e financiare;
- 1.4. për zbatimin e koordinuar të planit të veprimit për barazi gjinore në komunë;
- 1.5. të angazhohet në sigurimin e realizimit të të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, të garantuara me kushtetutë dhe ligj;
- 1.6. të përcaktojë dhe paraqes masa për promovimin e mundësive të barabarta midis burrave e grave për të eliminuar diskriminimin direkt dhe indirekt, bazuar në gjininë, në jetën publike të vendit;
- 1.7. të përcaktojë përgjegjësitë e administratës së komunës për të hartuar politikën për promovimin e një shoqërie gjinore të barabartë dhe
- 1.8. shqyrton edhe çështje tjera të cilat lidhen me barazinë gjinore që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore por të cilat delegohen nga organet tjera lokale dhe qendrore.

10) Komiteti Konsultativ i Ekspertëve të Planifikimit Hapësinorë (trup e jashtme e Kuvendit të Komunës)

Neni 13

1. Komiteti Konsultativ i Ekspertëve të Planifikimit Hapësinorë si trup e jashtme e Kuvendit të Komunës është përgjegjës:

- 1.1. të jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (planit zhvillimor komunal, planit zhvillimor urban dhe planeve rregulluese urbane) të cilat i miraton Kuvendi i Komunës.
- 1.2. të ofrojë këshilla profesionale në procesin e hartimit të planeve zhvillimore, urbane dhe planeve rregulluese urbane, si dhe në procesin e zbatimit të këtyre planeve;
- 1.3. shqyrton dhe propozon zgjidhje përkatëse në rastet e jo harmonizimit të strategjive zhvillimore;
- 1.4. përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat në pajtim me dispozitat ligjore miratohen në Kuvendin e Komunës;
- 1.5. monitoron zbatimin e planeve komunale dhe dokumenteve tjera të miratuara nga ana e KK-së kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e planifikimit hapësinor brenda komunës;
- 1.6. shqyrton edhe çështje tjera të cilat lidhen me planifikimin hapësinor të komunës, që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, por të cilat delegohen nga organet tjera lokale dhe qendrore.

Mbledhjet dhe rendi në mbledhje

Neni 14

1. Në parim, mbledhjet e komiteteve mbahen njëherë (1) herë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shumë. Mbledhjet e komiteteve kryesohen nga Kryesuesit, kurse në mungesë të tyre nga anëtar i vjetër i komitetit për nga mosha.

2. Në rast të mungesës së drejtorit në mbledhje të komitetit përkatës, duhet ta caktoi përfaqësuesin e vet të autorizuar, për pjesëmarrje vetëm në atë mbledhje të komitetit përkatës.
3. Zyrtarët dhe personat tjerë që nuk janë anëtarë të komiteteve, por që janë të pranishëm në mbledhje, do të lejohen nga ana e kryesuesit të flasin dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre.
4. Kryesuesi i komitetit përkatës mund ta urdhërojë një anëtar ose zyrtar tjetër i cili sipas mendimit të tij bënë veprime që prishin rendin gjatë mbledhjes së komitetit dhe që janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përmbahet rregullave të punës në komitet. Në rast se anëtari ose zyrtari tjetër edhe pas urdhrit që t'i përmbahet rregullave të punës në komitet, vazhdon t'i shkelë rregullat e punës së komitetit, kryesuesi mund ta urdhërojë që ta lëshojë mbledhjen e komitetit vetëm për atë takim.

Neni 15

1. Shqyrtimi i ndonjë akti të përgjithshëm juridik ose ndonjë propozim tjetër përmbajtjesor të shkruar, të dorëzuar në komitetin përkatës nga ana e drejtorisë së linjës ose nga institucionet dhe shoqatat e ndryshme, do të bëhet në pajtim me rendin si vijon:
 - 1.1. propozuesi i projekt- aktit të përgjithshëm ose propozimit tjetër përmbajtjesor do të flasë i pari,
 - 1.2. në rast se propozuesi nuk është anëtar i komitetit, drejtori i drejtorisë së linjës do të ketë të drejtë të flasë i dyti dhe kryesuesi i treti dhe anëtarët e tjerë, sipas radhës dhe zyrtarët profesional të drejtorive të linjës;
 - 1.3. në fund të debatit, propozuesi i projekt-aktit të përgjithshëm ose i propozimit tjetër përmbajtjesor, do të ketë të drejtë të përgjigjet dhe të bëjë komente dhe pastaj kryesuesi i komitetit përkatës përmbyll debatin (shqyrtimin).

Neni 16

Një anëtar i komitetit, mund të flasë vetëm një herë gjatë rrjedhës së një debati, për një pikë të rendit të ditës, me qëllim të qartësimit dhe të sqarimeve apo të dhënies së përgjigjeve do të ketë të drejtën edhe njëherë të diskutoj. Fjalimet e anëtarëve të komitetit dhe të drejtorit të linjës, zgjasin më së shumti pesë (5) minuta. Personat tjerë në komitet mund të flasin më së shumti tre (3) minuta.

Neni 17

1. Kryesuesi i komitetit duhet të kujdeset që ta mbaje rendin në komitet. Anëtari i komitetit, zyrtarët dhe personat tjerë janë të detyruar t'i respektojnë rregullat e punës në komitet dhe t'i zbatojnë urdhrat eventuale të kryesuesit të komitetit.
2. Kryesuesi i komitetit përkatës mund të urdhërojë një anëtar ose zyrtar tjetër i cili sipas mendimit të tij veprimet e tij ose saj janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përmbahet rregullave të punës në komitet.
3. Anëtarëve të komiteteve ju ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i celularëve në mbledhje.

Neni 18

1. Në rast të ndonjë parregullsie serioze që paraqitet në komitet, kryesuesi komitetit mund ta shtyj mbledhjen në tërësi, ose mund ta pezullojë atë për një kohë të caktuar dhe e njofton kryesuesin e kuvendit të Komunës.
2. Në rast se në mbledhjet e komiteteve marrin pjesë zyrtarët e organeve ose institucioneve tjera, personat tjerë dhe përfaqësuesit e shtypit, duhet të respektojnë kodin e mirësjelljes, nëse nuk ka rregulla tjera të sjelljes përkitazi me pjesëmarrjen dhe sjelljen e zyrtarëve të organeve ose institucioneve tjera, për persona tjerë dhe përfaqësues të shtypit që ndjekin mbledhjet e komitetit.
3. Kryesuesi komitetit kërkon nga të gjithë personat që t'i respektojnë rregullat e tilla, e në rast se nuk i respektojnë të largohen nga mbledhja.

Përcaktimi i rendit të ditës

Neni 19

1. Kryesuesi i komitetit përkatës në bashkëveprim me strukturat relevante dhe drejtoritë e linjës propozon rendin e ditës për mbledhje.
2. Kryesuesi i komitetit, do të kujdeset që në rendin e ditës të jenë çështjet me prioritet të përcaktuara nga ana e drejtoritë të linjës dhe organeve tjera të komunës posaçërisht kuvendit të komunës.
3. Anëtarët e komitetit mund të miratojnë rendin e propozuar ose të kërkojnë modifikimin e tij duke bërë propozimin konkretë, por që nuk është në kundërshtim me përgjegjësit e komitetit përkatës.
4. Për çështjet e rendit të ditës për të cilat nuk mund të arrihet pajtimi mund të barten në mbledhjen e ardhshme të komitetit, kurse kryesuesi ndërkohë duhet të zhvillojë konsultime për të arritur pajtime për çështjen e bartur.

Çështjet e ngutshme

Neni 20

1. Në të gjitha mbledhjet e komitetit, çdo anëtarë që paraprakisht e ka marrë lejen kryesuesit të komitetit, mund të propozojë që komiteti menjëherë të marrë parasysh një çështje të ngutshme me interes të veçantë publik, e cila është paraqitur në kohën midis dy mbledhjeve të komitetit. Nëse kryesuesi së bashku me anëtarët e komitetit, konsideron se çështja meriton vëmendjen e menjëhershme të komitetit, ai do të lejojë anëtarin në fjalë që të arsyetojë propozimin e tij në komitet, dhe pastaj do të vë në votim atë çështje.
2. Përrjashtimisht, kur propozimi i bërë nuk është bërë nga një anëtar i komitetit, atëherë drejtorit të drejtorisë së linjës, do t'i lejohet të paraqes pikëpamjet e veta, para se të votohet. Nëse komiteti vendos të marrë parasysh çështjen, atëherë duhet ta bëjë një gjë të tillë gjatë takimit, ndërsa orari i punës duhet të përshtatet sipas kësaj.

Votimi

Neni 21

1. Komitetet për çështjet e shqyrtuara mund të bëjnë rekomandime në KPF dhe në Kuvendin e Komunës duke dhënë arsyetime përkatëse.
2. Nëse komiteti për çështje të caktuara duhet të votojë për rekomandimin përkatës, vendimi duhet të merret me konsensus të të gjithë anëtarëve të komitetit, mirëpo nëse

kjo nuk mund të arrihet, vendimet merren me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

3. Votimi bëhet sipas mënyrës “për“ – “kundër“ – “abstenim“ me ngritje dore. Në rast të numrit të barabartë të votave të hedhura “për“ dhe “kundër“ ndonjë propozimi, kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave.

Ndihma teknike për komitete

Neni 22

Njësia e Kuvendit, do të ofrojë mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për sigurimin e kushteve të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve, duke përfshirë: shpërndarjen e materialeve për mbledhje, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen procesverbaleve në dosje dhe të materialeve të tjera të komiteteve.

Ndryshimi i rregullores

Neni 23

1. Kryesuesi i komitetit, e shqyrton vazhdimisht rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, me arsyetim përkatës. Me propozimin për ndryshimin e kësaj rregulloreje duhet të njoftohen edhe komitetet tjera para se Kuvendi të marrë vendim për ndryshimin apo plotësimin e kësaj rregulloreje.
2. Propozimin për ndryshimin e rregullores sipas paragrafit **1** të këtij neni, mund ta paraqes çdo anëtar i komitetit përkatës, mbështetur nga së paku 1/3 e anëtarëve të tjerë. Vendimin përfundimtar për ndryshimin e rregullores e merr Kuvendi i Komunës.

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 24

1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që është në kundërshtim me LVL, Statutin e Komunës dhe aktet tjera nënligjore nuk do të zbatohet.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

nr. 016-60795
Gjilan, më 29.06.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/